

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E ENJTE 20 TETOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot na është paraqitur për miratim projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë ne protokollin e dytë shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik mbi Bashkëpunimin e Zgjeruar dhe Zbulimin e Provave Elektronike”.

Dua të theksoj që në fillim të diskutimit tim se vota ime është pro për nënshkrimin e këtij protokollin, i bindur se një konventë e tillë është në të njëjtën frymë bashkëpunimi si Konventa e Ekstradimit, apo e ndihmës reciproke ligjore në çështjet penale. Për hir të së vërtetës, krimi kibernetik ka kohë që shqetëson vendet perëndimore me demokraci të zhvilluar, sepse teknologjia numerike vërtet sjell avantazh për zhvillim, por paralelisht ajo përdoret edhe nga rrjetet kriminale dhe terroriste, që, siç e dimë, kanë fuqi financiare për të blerë teknikë të zotë. Nëse deri sot thuhej se krimi nuk ka kufi, ilustrimi më ideal i tij është krimi kibernetik, ndaj dhe bashkëpunimi mbetet jetik. Megjithatë, kjo mbetet njëra anë e medaljes, sepse zhvillimi i teknologjisë së informacionit nuk rrezikohet vetëm nga kriminelët. Ndërtimi i tyre ka sjellë edhe sfida për shoqëritë bashkëkohore, sfida këto të lidhura me raportet ndërmjet informatikës dhe menaxhimit të të dhënave me karakter profesional, të lidhura ngushtë me të drejtën e individit për privatësi dhe keqpërdorimit të saj në raport me funksionimin e institucioneve të shtetit të së drejtës, dy elemente këto që qeverisja aktuale e vendit tonë nuk i ka pasur parasysh, por i ka përdorur për përfitime politike. Mjafton të kujtojmë këtu shkeljen flagrante të bërë nga qeveria lidhur me kalimin e të dhënave me karakter personal të të gjithë shtetasve shqiptarë, në mënyrë tërësisht antiligjore, në duart e patronazhistëve.

Të dhënat personale në arkivat elektronike përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë krijuar, por në rastin e mësipërm qeveria i ka deformuar, duke shkelur ligjin.

Sipas raportit të ekspertëve të FBI-së dhe CISA-s, sulmi kibernetik i hakerave iranianë ka filluar 14 muaj para datës 16 korrik 2022, pra më 14 maj 2021, gjë që lidhet me daljen e listës së patronazhistëve të publikuar në datën 11 prill 2021, duke e vënë kështu portalin *e-Albania* në dispozicion të maxhorancës për qëllime politike, gjë të cilën e tregon edhe konkluzioni i ekspertëve të huaj se sulmi e ka zanafillën e daljes së kësaj liste nga *e-Albania*, me të dhëna shumë sensitive për qytetarët shqiptarë, pasi një muaj mbrapa hakerat iranianë filluan sulmin, duke lundruar në sistemet informatike të shtetit tonë. Pas sulmit të fundit të shtatorit hakerat postojnë gati çdo ditë të dhënat e hakeruara edhe nga sisteme të rëndësishme të Policisë së Shtetit, duke gjuhëzuar kështu sistemet tona kibernetike me nxjerrjen në pazar apo publikimin e të dhënave sensitive nga sistemi TIMS për drejtorin e Shërbimit Informativ, të hakeruara dhe të publikuara nga *Homeland Justice*. Ky është pa asnjë diskutim cenim i sigurisë kombëtare, i informacionit dhe të dhënave shumë sensitive, që cenojnë sigurinë e qytetarëve dhe të shtetit tonë.

Investimi në këta 9 vjet i shumës prej 192 milionë euro, ku pjesa e madhe e këtyre fondeve janë marrë nga tri kompani vendase dhe rrëzimi me lehtësi i sistemeve mbrojtëse, tregon se këto kompani krijojnë dyshime të arsyeshme në mënyrën e përdorimit dhe në eficiencën e këtyre fondeve. Këto sisteme janë ndërtuar nga kompani vendase, por jo me sisteme me infrastrukturë mbrojtëse, prandaj kërkohet të kryhet një auditim dhe një certifikim serioz i këtyre sistemeve të shtrenjta, por edhe i përdorimit të parasë publike të shpenzuar nga qeveria për ndërtimin dhe mbrojtjen e këtij sistemi.

Për të bërë diferencën e sistemeve mbrojtëse ndaj këtyre sulmeve kibernetike mjafton krahasimi me sistemet e Republikës së Kosovës, por edhe të sistemeve të SHISH-it dhe Ministrisë së Mbrojtjes, ku në këto dy institucione është investuar si me pajisje, ashtu dhe me asistencë dhe certifikim të këtyre sistemeve nga partnerët tanë të NATO-s dhe SHBA-ve, ku edhe aty ka pasur sulme të hakerave iranianë e rusë në vazhdimësi, por këto sisteme u kanë rezistuar me sukses këtyre sulmeve. Ajo që kërkohet sot nga qeveria, nga AKSHI dhe nga institucionet e tjera përgjegjëse për sigurinë kibernetike është ngritja e sistemeve mbrojtëse bashkëkohore, solide dhe të certifikuara nga organizma të huaj të specializuar në këto fusha.

Ne dënojmë me ashpërsinë më të madhe sulmet kibernetike iraniane, ruse, kineze apo të çfarëdo agresori tjetër dhe të çfarëdolloj forme, duke përshëndetur vendimin e qeverisë për ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Islamike të Iranit. Këto sulme u dënuan me ashpërsi edhe nga Kongresi i SHBA-ve, duke theksuar se Irani vazhdon të jetë boshti i së keqes për sigurinë dhe paqen në mbarë botën.

Nga ana tjetër, AKSHI, duke qenë një agjenci në varësi të Kryeministrit, duhej të mbetej një agjenci e cila si detyrë të vetme duhet të kishte zhvillimin dhe orientimin teknik të teknologjisë kibernetike të vendit, ndërtimin e politikave për sigurinë e tyre, ndërkohë që nëpërmjet arkitekturës së ndërtuar për sistemin krijoi *e-Albania*. Kjo e fundit reklamohet si lehtësi për qytetarët, por, nga ana tjetër, nëpërmjet një sistemi të brendshëm arrijmë të lexojmë të gjitha të dhënat e sistemeve të tjera, fakt ky që e ka kthyer AKSHI-n në një agjenci operacionale në varësi të Kryeministrit.

Përse duhet të jetë në varësi të Kryeministrit një sistem informatik si *e-Albania*, që është në shërbim të qytetarëve? Sepse ky sistem krijon mundësinë e stokimit të të dhënave në një dorë, atë të Kryeministrit, dhe që ky i fundit t'i përdorë ato për përfitime politike, duke përqendruar pushtetin në duart e tij. Pra në vend të Këshillit të Ministrave, Kryeministri po qeveris nëpërmjet agjencive, siç është rasti i AKSHI-t. Në thelb kemi të bëjmë me përdorimin e teknologjisë për centralizimin e pushtetit.

A ka ndonjë institucion administrativ që të kontrollojë AKSHI-n nëse funksionon në përputhje me ligjin apo jo? Në këtë kontekst të shihen mundësitë për përmirësim ligjor. A ka ushtruar ndonjëherë kontroll tek AKSHI Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale? Ky institucion duhet parë ligjërisht, duke i dhënë atributë kontrollit administrativ të menaxhimit të të dhënave në mënyrë elektronike. Këto pyetje duhen diskutuar, në mënyrë që çështja e sistemeve informatike të shihet e plotë, në një këndvështrim administrativ, ligjor teknik dhe penal. Por duket qartë që qeveria është joshur nga fuqia e madhe që të jep informacioni nëpërmjet teknologjisë, duke e përqendruar në një dorë dhe duke pasur përparësi sigurinë e tyre, që aktualisht është e dëmtuar rëndë, e bashkë me to edhe siguria e vendit.

Ajo që thotë Kryeministri lidhur me sulmet ndaj sistemeve tona informatike duket qartë që është vetëm maja e ajsgut, sepse pa ndihmën e partnerëve tanë, sot vendi ynë do të rrezikohej edhe nga katastrofa të frikshme të mjeteve të transportit, siç janë fluturimet me avionë me viktime të shumta.

Siç e thashë, AKSHI është një agjenci në varësi të Kryeministrit dhe ka shpenzuar miliona euro për zhvillimin e sistemeve për sigurinë e tyre, por qysh në fillim të sulmit të parë dështoi. Ngrehina e sistemeve u rrëzua, dhe siguria kombëtare u vu në rrezik.

Ky protokoll që paraqitet sot për miratim, parashikon bashkëpunimin ndërkombëtar kundër kriminelëve dhe terroristëve, por në vendin tonë po aq i rrezikshëm është edhe keqpërdorimi i teknologjisë numerike. Faleminderit!